

K O N K L U Z I O N
Nr.08-1059/1 dt. 15.09.2014
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR FORMIMIN E TRUPIT TË PUNËS
PRANË KËSHILLIT TË KOMUNËS DIBËR

257.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për formimin e trupit të punës pranë Këshillit të Komunës, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 16^{të} dt. 29.08.2014.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M
Nr.07-959/3 dt.29.08.2014
PËR FORMIMIN E TRUPIT TË PUNËS PRANË KËSHILLIT TË
KOMUNËS DIBËR

258.Në mbështetje të nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 16^{të} dt. 29.08.2014 vendosi:

1.Formohet trupi i punës pranë Këshillit të Komunës Dibër për grumbullimin e informatave për përpilimin e strategjisë për shpëtim të Lumit Radikë.

2. Në trupin e punës nga pika 1 e vendimit zgjidhen:

- Abdyl Koleci
- Bardhyl Marku
- Reshat Qormemeti
- Gazmend Cami
- Aleksandra Bujanovska
- Daniela Jovanovska
- Lupço Melkovski
- Samet Abdul
- Allmir Osmanovski
- Ana Alizoti
- Bashkim Axhirexha

3.Detyrat e trupit të punës nga pika 1 e vendimit:

- shqyrtimi i dokumenteve të shpallura në wep faqen e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapsinor,

-shqyrtimi i nivelit aktual të procedurës ligjore në lidhje me Projektin,

-analizë dhe arsyetim të anëve negative që sjell projekti për Rajonin e rrjedhës natyrore të lumit të Radikës nga devijimi,

-përilimi i strategjisë për shpëtim të lumit të Radikës nga devijimi.

-matja e sasisë ujore te burimet.

4.Për aktivitetet e marra trupi i punës të raportojë Këshillit të Komunës Dibër.

4. Kopje e vendimit të dërgohet anëtarëve të trupit të punës.

5.Ky vendim hyn në fuqi ditën e shpalljes në Kumtesën zyrtare të Komunës.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08-1059/2 dt. 15.09.2014
PËR SHPALLJE TË AKTVENDIMIT PËR SHKARKIM DHE ZGJEDHJE
TË ANËTARIT TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE MANDATORE,
ZGJEDHJE DHE EMËRIME

Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet aktvendimi për shkarkim dhe zgjedhje të anëtarit të komisionit për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërimë , miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 16^{të} dt. 29.08.2014.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata

A K T V E N D I M
Nr. 07-959/4 dt. 29.08.2014
PËR SHKARKIM DHE ZGJEDHJE TË ANËTARIT TË KOMISIONIT
PËR ÇËSHTJE MANDATORE, ZGJEDHJE DHE EMËRIME

260.Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit për vetadministrim lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 5/02), si dhe nenit 31 të Rregullores së Këshillit të Komunës (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.4/05),
Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 16^{të} dt. 29.08.2014 vendosi:

1.Nga komisioni për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërimë si komision i përhershëm pranë Këshillit të komunës Dibër shkarkohet anëtari:

-Fatmir Imerovski

2.Anëtar në komisionin nga pika 1 zgjidhet

-Afet Avmedoski

3.Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën Zyrtare të Komunës Dibër”.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08-1059/3 dt. 15.09.2014
PËR SHPALLJE TË AKTVENDIMIT PËR CAKTIMIN E ANËTARIT TË
KËSHILLIT TË KOMUNËS PËR LIDHJEN E
MARTESAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR

Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet aktvendimi për caktimin e anëtarit të Këshillit të Komunës për lidhjen e martesave në territorin e komunës së Dibrës,, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 16^{të} dt. 29.08.2014.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata

A K T V E N D I M
Nr. 07-959/5 dt. 29.08.2014
PËR CAKTIMIN E ANËTARIT TË
KËSHILLIT TË KOMUNËS PËR LIDHJEN E
MARTESAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR

264.Në mbështetje të dispozitave të Ligjit për familjen (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 80/92, 9/96, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/10, 156/10, 39/12 , 44/12 dhe 38/14),si dhe nenit 59 të Statutit të Komunës së Dibrës (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 16 dt. 29.08.2014 vendosi:

1.Anëtar i Këshillit të Komunës për lidhjen e martesave në territorin e komunës së Dibrës, respektivisht për territorin e gjendjes civile në f.Kosovrast të Poshtëm dhe të Epërm, Gari, Osoj dhe Mogorçë në vend të këshilltarit Fatmir Imerovski caktohet:

-Afet Avmedoski

2.Për përcaktimin e anëtarit të Këshillit për lidhjen e martesave në territorin e komunës së Dibrës, të njoftohen anëtari i Këshillit, Zyra rajonale për mbajtjen e librave amë-Dibër si dhe shërbimet tjera.

3.Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën Zyrtare të Komunës Dibër.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08-1059/4 dt. 15.09.2014
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR METODOLOGJINË PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR SHPËRNDARJEN E BLOK
DOTACIONIT PËR SHKOLLAT FILLORE NË TERRITORIN E
KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2014

Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për metodologjinë për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e bllok dotacionit për shkollat fillore në territorin e Komunës Dibër për vitin 2014, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 16^{të} dt. 29.08.2014.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata

V E N D I M

Nr.07-959/6 dt.29.08.2014

PËR METODOLOGJINË PËR PËRCAKTIMIT E KRITEREVE PËR SHPËRNDARJEN E BLOK DOTACIONIT PËR SHKOLLAT FILLORE NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2014

266.Në mbështetje të nenit 62 paragrafi 1 të Ligji për vetadministrim lokale (“Gazeta zyrtare e R.M.” nr 05/02) nenit 8 paragrafi 2 pika 4 të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale (“Gazeta zyrtare e R.M.” nr 61/04, 96/2004 , 67/2007 , 156 /2009, 47 /2011) dhe nenit 27 paragrafi 1 pika 44 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr 14/03),
Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 16^{të} dt. 29.08.2014 vendosi:

Neni 1

Me këtë vendim përshkruhet metodologjia për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e bllok dotacionit për shkollat fillore në territorin e Komunës Dibër.

Neni 2

Në pajtim me Buxhetin e Komunës Dibër për vitin 2014 , në programin H1 dhe nënprogramin H10 -Arsimi fillor, bëhet financimi i 3(tre) shkollave fillore në territorin e Komunës Dibër.

Neni 3

Mjetet e përcaktuara nga neni 2 i këtij Vendimi sipas qëllimit shpërndahen për ç’do shkollë fillore në bazë të të dhënave të dërguara nga shkollat fillore dhe planeve të tyre financiare vjetore.

Neni 4

Kriteret për shpërndarjen e bllok dotacionit për shkollat fillore janë :

- shuma e përgjithshme nga bllok dotacioni për 2014 lëshuar nga Ministria e arsimit dhe shkencës,
- numri i përgjithshëm i nxënësve në nivel të komunës, respektivisht sipas shkollave fillore dhe
- madhësisë së shkollës

Rrogat bruto meqë janë llogaritur dhe dhënë si obligim i detyrueshëm sipas numrit të të punësuarve, minusohen nga metodologjia për shpërndarje.

Neni 5

Shpërndarja bëhet vetëm e mjeteve nga bllok dotacioni të cilat shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve materiale sipas formulës vijuese:

$$PQ=(nr. nxë.x 0,5)+(nr.pu.x 0,5):(nr.to. nxë.x 0,5)+(nr.tot. i pu. x 0,5)$$

PQ- Pjesa qëllimore për mbulesë të shpenzimeve materiale për vitin 2014 -98.338.000 den. është vlera e bllok dotacionit për shkolla fillore nga të cilat,

-91.400.000 den. është vlera totale e rrogave bruto për të gjitha SHF dhe
- 6.983.800 den. është diferenca që mbetet për shpërndarje për shpenzimet materiale.

K nx-koeficienti i nr. të nxënësve

K pu-koeficienti për numrin e të punësuarve.

TABELA PËR FORMULËN

SHPËRNDARJA E PJESËS QËLLIMORE TË BLOK DOTACIONIT (PA RROGAT BRUTO)

pjesa qëllimore për vitin 2014 është 6.983.800 den.

Knx-koeficienti i numrit të nxënësve=0,5 dhe

Kpu-koeficienti për numrin e të punësuarve=0,5

Nr. rën.	Emri i shkollës	Sipërf. totale	Numri i përgjit. i nxë.	Koefic ienti	Për qindja	Total
1	SHF "Penestia"	1075	120	1295	49	51(+2)
2	SHF "Said Najdeni"	510	71	581	25	26(+1)
3	SHF "Riste Risteski"	564	60	624	26	23 (-3)
	Gjithsejt	2149	251	2500	100	100

Në tabelën në kolonën e përqindjes së shpërndarjes bëhet koreksion gjegjësisht zvogëlim për 3 apoen (%) nga SHF "Riste Risteski" në llogari të SHF"Penestia" të cilës i jepen 2 apoena (%) dhe SHF "Said Najdeni" 1 apoen (%), meqenëse këto shkolla kanë nxemje qëndrore me naftë.

Neni 6

Mjetet nga bllok dotacioni shpërndahen për shkollat fillore nëpërmjet Njësisë për çështje financiare për rrogat bruto dhe shpenzimet materiale për ç'do muaj, gjegjësisht ashtu si transferohen mjetet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Neni 7

Në pajtim me kriteret e përmendura kryhet shpërndarja e bllok dotacionit për shkollat fillore për 2014 të llogaritura në tabelën me të dhëna në shumë absolute dhe përqindje, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi .

Neni 8

Vendimi hyn në fuqi nga dita e shpalljes në „ Kumtesën zyrtare të komunës Dibër „,

KËSHILLI I KOMUNËS

Kryetari,

Bashkim Mashkulli d.v.

P Ë R M B A J T J A

257	Konkluzion për shpallje të vendimit për formimin e trupit të punës pranë Këshillit të Komunës	___	465
258	Vendim për formimin e trupit të punës pranë Këshillit të Komunës	___	466
259	Konkluzion për shpallje të aktvendimit për shkarkim dhe zgjedhje të anëtarit të komisionit për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërimë	___	467
260	Aktvendim për shkarkim dhe zgjedhje të anëtarit të komisionit për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërimë	___	468
261	Konkluzion për shpallje të aktvendimit për caktimin e anëtarit të Këshillit të Komunës për lidhjen e martesave në territorin e komunës së Dibrës	___	469
262	Aktvendim për caktimin e anëtarit të Këshillit të Komunës për lidhjen e martesave në territorin e komunës së Dibrës,	___	470
263	Konkluzion për shpallje të vendimit për metodologjinë për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e bllok dotacionit për shkollat fillore në territorin e Komunës Dibër për vitin 2014	___	471
264	Vendim për metodologjinë për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e bllok dotacionit për shkollat fillore në territorin e Komunës Dibër për vitin 2014	___	472